

## Republika e Maqedonisë

### Komuna e Tearcës

Në bazë të neneve 4,7 dhe 36 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e R.M." nr.5/02), Këshilli i Komunës së Tearcës në seancën e mbajtur më 28.05.2007, miratoi:

## STATUTI

### I KOMUNËS SË TEARCËS

#### I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

##### Neni 1

Komuna e Tearcës është e themeluar dhe rajoni i saj është përcaktuar me Ligjin për organizimin territorial të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë ("Gazeta zyrtare e R.M." nr.55/04).

Territori i komunës së Tearcës i përfshin këto vendbanime: Tearcë, Neproshten, Leshkë, Sllatinë, Përshëfc, Glllogjë, Dobrosht, Odër, Nerasht, Përc, Jelloshnik, Varavarë dhe Breznë.

##### Neni 2

Me këtë Statut të komunës së Tearcës (në tekstin e mëtutjeshëm: Komuna), në pajtueshmëri me ligjin, përcaktohen:

- organizimi dhe puna e organeve të komunës;
- organizimi dhe puna e komisioneve të Këshillit të komunës;
- kryerja e punëve në pajtueshmëri me parimin e subsidiaritetit;
- mënyra e informimit të qytetarëve dhe qasje e lirë në informatat me karakter publik;
- rastet e përjashtimit të opinionit nga seancat e Këshillit të komunës;
- mënyrën dhe procedurën për paraqitjen e parashtresave dhe propozimeve për punën e organeve të komunës dhe veprimin sipas tyre;
- mënyrën e organizimit të tribunave publike, zbatimin e akteve dhe grumbullimin e propozimeve të qytetarëve;
- mënyrën e shpalljes së rregullave të Këshillit;
- mënyrën e kryerjes së obligimeve nga sfera e mbrojtjes në gjendje lufte;
- vetëvendosjen vendore;
- mënyrën dhe procedurën për përcaktimin e stemës dhe flamurit të komunës;
- pronësia dhe finacimi i komunës;
- çështje të tjera me rëndësi për komunën.

### **Neni 3**

Çështje të caktuara lidhur me realizimin e kompetencave, procedurat e punës dhe vendosjen në Këshillin e komunës, rregullohen për së afërmi me Rregulloren e Këshillit të komunës (në tekstin e mëtutjeshëm: Rregullore).

Rregulloren e nxjerr Këshilli i komunës (në tekstin e mëtutjeshëm: Këshilli), me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit.

### **Neni 4**

Komuna e Tearcës ka festën e vet.

Festa e Komunës së Tearcës është "**20 Dhjetori**"- dita e konstituimit të Këshillit të parë pluralist të komunës së Tearcës.

### **Neni 5**

Komuna e Tearcës ka stemën dhe flamurin.

### **Neni 6**

Stema e komunës së Tearcës ka formën e patkonit ku në pjesën e poshtme mbyllet në formë të elipsës. Skajet e stemës janë me ngjyrë ari ku në pjesën e epërme është shënuar data e seancës së parë konstituive të Këshillit të komunës së Tearcës 20.12.1996. Malet paraqesin tre majat më të larta në komunë, ndërsa katër topthat me ngjyrë të bardhë simbolizojnë katër vendbanimet kodrinoro-malore në komunë. Nëntë katrorët me ngjyrë të bardhë dhe të përhimtë në formë të shiritit paraqesin nëntë vendbanimet fushore të komunës, ndërsa sipërfaqet në brendi me ngjyrë të gjelbërt dhe kafe paraqesin tokën punuese bujqësore si veprimtari primare në komunë.

Shtylla e përhimtë në të cilën mbështetet shiriti me ngjyrë të përhimtë dhe të bardhë formojnë shkronjën "T" e cila është shkronja fillestare e komunës.

### **Neni 7**

Baza e flamurit të komunës së Tearcës është me ngjyrë të kaltër. Nga skaji i majtë lartë kah skaji i djathtë poshtë tërhiqet shiriti me ngjyrë ari.

Në mesin e flamurit mbi shirit qëndron stema e komunës. Përpjestimi i gjërësisë dhe gjatësisë së flamurit është 1:2.

### **Neni 8**

(1) Për përcaktimin e stemës dhe të flamurit të komunës, Këshilli shpall konkurs dhe formon Komision.

(2) Komisioni nga punimet e marra pas konkursit të shpallur përcakton propozim për stemën, gjegjësisht flamurin, dhe ia dërgon Këshillit për miratim.

### **Neni 9**

(1)Komuna e Tearcës ka vulë me formë të rrumbullakët me diametër 3,5 centimetër, në mesin e së cilës shkruan "Tearcë", në gjuhën shqipe dhe në gjuhën maqedonase, kurse skajeve është shkruar teksti "Republika e Maqedonisë-komuna e Tearcës" në gjuhën shqipe dhe maqedonase.

(2)Vulën që e përdor kryetari i komunës, në reshtin e dytë ka mbishkrimin "Kryetari i komunës" në gjuhën shqipe dhe maqedonase.

(3)Komuna ka vulën e vet katrore dhe vulën katrore të pranimit.

(4)Vula katrore dhe vula e pranimit janë në dy gjuhë, në gjuhën maqedonase dhe shkrimin e saj cirilik dhe gjuhën shqipe me shkrimin e saj.

## **Bashkëpunimi ndërkomunal**

### **Neni 10**

Komuna, me Vendim të miratuar nga Këshilli i komunës mund të bashkohet në union në pajtim me ligjin.

### **Neni 11**

(1)Me qëllim të mbrojtjes dhe përparimit të interesave të përbashkëta, komuna me Vendim të miratuar nga Këshilli i komunës ka mundësi:

-Të bashkohet në shoqata në përputhje me ligjin.

-Të sjell vendim, që së bashku me komunat tjera të Republikës të bashkojë mjete dhe të formojë shërbime publike të përbashkëta, me qëllim të realizimit të interesave të përbashkëta dhe kryerjes së punëve të përbashkëta nga kompetencat e tyre në përputhje me ligjin.

-Me marrëveshje me komunat tjera, mund të formojë trupa të përbashkët administrativ në sfera të caktuara, me qëllim të zbatimit të kompetencave të caktuara në përputhje me ligjin.

### **Neni 12**

(1) Komuna sjell vendime për bashkëpunim me komunat e Republikës, me njësitë e vetëqeverisjes lokale të vendeve të tjera si dhe organizatat ndërkombëtare të bashkësive vendore dhe pushteteve lokale.

(2) Komuna mund të anëtarësohet në organizatat ndërkombëtare të pushteteve lokale.

### **Neni 13**

Këshilli i komunës me qëllim të mbrojtjes dhe përparimit të interesave të përbashkëta me komunat tjera, sjell vendim që komuna të bashkohet në shoqatën e komunave të R.M.

## **II.KOMPETENCAT E KOMUNËS**

### **Neni 14**

Komuna, në suaza të ligjit dhe këtij Statuti, në mënyrë të pavarur i rregullon dhe ushtron punët me interes publik dhe rëndësi lokale, të përcaktuara me Ligjin për vetëqeverisje lokale ose me ligj

tjetër, si dhe punët që nuk janë përjashtuar nga kompetenca e saj ose nuk janë në kompetencë të organeve të qeverisë shtetërore.

### **III. ORGANIZIMI DHE PUNA E ORGANEVE TË KOMUNËS**

#### **Këshilli i komunës**

##### **Neni 15**

(1) Këshilli i komunës është organ përfaqësues i qytetarëve.

(2) Këshillin e komunës së Tearcës e përbëjnë 19 anëtarë përfaqësues të qytetarëve të zgjedhur në zgjedhje të përgjithshme, të drejtëpërdrejta dhe të lira me votim të fshehtë.

(3) Mandati i anëtarëve të Këshillit zgjat 4 (katër) vjet.

(4) Anëtari i Këshillit nuk mund të revokohet.

#### **a) Konstituimi**

##### **Neni 16**

(1) Konstituimi i Këshillit bëhet me verifikimin e mandatit të anëtarëve të Këshillit të zgjedhur në mënyrë të përcaktuar me ligj dhe me vënien e nënshkrimit dhe dhënien e deklaratës solemne sipas përmbajtjes së përcaktuar me ligj.

(2) Verifikimi i mandatit të anëtarëve të Këshillit bëhet në seancën e parë konstituive të Këshillit, me propozimin e Komisionit për çështjet e verifikimit, zgjedhje dhe emërime që formohet në fillim të seancës nga radhët e anëtarëve të posazgjedhur të Këshillit.

(3) Verifikimi i mandatit të anëtarëve të Këshillit që nuk kanë qenë të pranishëm në seancën e parë të Këshillit e bëjnë në seancën e parë në të cilën do të marrin pjesë ata.

##### **Neni 17**

Procedura për verifikimin e mandatit të anëtarëve të Këshillit përcaktohet për së afërmi me Rregulloren për punë të Këshillit të komunës së Tearcës.

##### **Neni 18**

Anëtarët e Këshillit japin dhe nënshkruajnë deklaratë solemne, si më poshtë:

"Unë (emri dhe mbiemri) solemnisht deklaroj se të drejtat dhe detyrimet e anëtarit të Këshillit do t'i ushroj me ndërgjegje dhe gjatë ushtrimit të tyre do t'a respektoj Kushtetutën, ligjet, aktet e Këshillit dhe do ta mbroj rendin kushtetues të Republikës së Maqedonisë".

#### **b) Të drejtat dhe obligimet e anëtarëve të Këshillit.**

##### **Neni 19**

(1) Anëtari i Këshillit ka të drejtat dhe obligimet të përcaktuara me ligj dhe me këtë Statut.

(2) Anëtari i Këshillit i merr të drejtat dhe obligimet e veta pas verifikimit të mandatit.

(3) Të drejtat dhe obligimet e anëtarit të Këshillit janë:

- të propozojë debat për çështje, dukuri dhe gjendje që janë me rëndësi vendore si dhe me rëndësi për qytetarët e komunës;
- të ngrejë iniciativa për nxjerrjen e vendimeve dhe akteve tjera nga kompetencat e Këshillit si dhe të propozojë amendamente në mënyrën dhe sipas procedurës të parashikuar me Rregullore;
- të kërkojë nga administrata e komunës (në tekstin e mëtutjeshëm: administrata) si dhe nga shërbimet publike, institutet dhe ndërmarrjet si dhe nga institucionet tjera të themeluara nga komuna, të dhëna dhe informata tjera për çështje nga fushëveprimi i vet e që i janë të nevojshme për punën e tij në Këshilli;
- të kërkojë dhe të marrë ndihmë profesionale në përgatitjen e propozimeve të cilat ia paraqet Këshillit, në paraqitjen e pyetjeve të këshilltarëve dhe në kryerjen e punëve të tjera të cilat ia ka besuar Këshilli, gjegjësisht komisioni në të cilin është anëtar;
- t'i ruaj si fshehtësi të dhënat të cilat janë klasifikuar si të tilla, që do t'i kuptoj në seancën e Këshillit apo të komisionit.

## **Neni 20**

(1) Anëtari i Këshillit ka të drejtë të jetë i pranishëm dhe të merr pjesë në punën e seancës të Komisionit të Këshillit, edhe pse nuk është anëtar i komisionit, por pa të drejtë vendosjeje.

(2) Anëtari i Këshillit i cili me arsye ka munguar në seancat e Këshillit dhe të komisionit anëtar i të cilit është, obligohet që për këtë ta njoftoj në kohë kryetarin e Këshillit dhe kryetarin e komisionit.

(3) Anëtari i Këshillit i cili me arsye një kohë të gjatë nuk ka marrë pjesë në seancat e Këshillit dhe të komisionit anëtar i të cilit është, ka të drejtë të kërkojë nga Këshilli t'ia arsyetojë mospraninë në seancat.

(4) Me kërkesën nga paragrafi 2 i këtij neni, Këshilli vendos pa zhvilluar debat.

## **c) Kryetari i Këshillit**

### **Neni 21**

(1) Këshilli i komunës zgjedh kryetar nga radhët e anëtarëve të Këshillit më mandat prej katër vjetësh.

### **Neni 22**

(1) Kryetarin e Këshillit e zgjedh Këshilli me votim publik, me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit

(2) Propozim për zgjedhjen e kryetarit të Këshillit mund ta jep Komisioni për çështje mandatare, zgjedhje dhe emërimë si dhe çdo anëtar i Këshillit.

(3) Zgjedhja e kryetarit të Këshillit mund të bëhet edhe me votim të fshehtë, nëse për një propozim të tillë të ndonjë anëtarit të Këshillit, vendos Këshilli me shumicë votash nga anëtarët e pranishëm të Këshillit.

(4) Procedura për zgjedhjen e kryetarit të Këshillit me votim të fshehtë rregullohet me Rregulloren.

### **Neni 23**

(1) Kryetari i Këshillit i thërret dhe i udhëheq seancat e Këshillit të komunës, kujdeset për organizimin dhe punën e Këshillit dhe i nënshkruan aktet që i ka miratuar Këshilli dhe në afat prej 3 (tre) ditësh prej ditës së miratimit të tyre ia dorëzon kryetarit të komunës për t'i shpallur.

### **d) Mënyra e punës**

### **Neni 24**

Këshilli punon në seanca të rregullta, kurse sipas nevojës mund të mbajë edhe seanca të jashtëzakonshme.

### **Neni 25**

(1) Këshilli i komunës i kryen punët e përcaktuara në kompetencë të tij, në përputhje me nenin 36 të Ligjit për vetëqeverisje lokale si dhe punët e përcaktuara si kompetencë e Këshillit me ligje të veçanta, të cilat për më së afërmi i rregullojnë sferat në të cilat komuna ka kompetenca.

### **Neni 26**

(1) Këshilli vendos me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm në Këshill, së paku me një të tretat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit.

(2) Votimi në seanca të Këshillit është publik, përpos nëse Këshilli nuk vendos për çështje të caktuara që votimi të jetë i fshehtë.

(3) Dispozitat që i përkasin kulturës, përdorimit të gjuhëve dhe shkrimeve në të cilën flasin më pak se 20% e qytetarëve në komunë, përcaktimi dhe përdorimi i stemës dhe flamurit të komunës miratohet me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm të Këshillit, gjatë së cilës domosdo të ketë shumicë votash të anëtarëve të pranishëm të Këshillit të cilët i përkasin bashkësisë që nuk është shumicë e popullsisë në komunë.

### **Neni 27**

(1) Thërritja e seancave të Këshillit, përcaktimi i rendit të ditës, rrjedha e seancës, procesverbalet, procedura e nxjerrjes së akteve dhe për çështje të tjera lidhur me punën e Këshillit, më përsëafërmi rregullohen me Rregullore.

(2) Dita, ora dhe vendi i mbajtjes së seancës së rregullt të Këshillit, si dhe propozimi i rendit të ditës sipas të cilit do të punojë seanca, shpallen në tabelën e komunës për shpallje.

(3) Kryetari i Këshillit mund të vendosë, që dita, ora dhe vendi i mbajtjes së seancës së Këshillit si dhe propozimi i rendit të ditës të shpallen në mjetet e informimit publik.

### **Neni 28**

Këshilli mban seanca solemne për shënimin e ngjarjeve të rëndësishme historike, kurse mund të mbajë edhe seanca solemne edhe për dëgjimin e fjalimeve të shtetasve tanë dhe të huaj,

përfaqësuesve të organizatave ndërkombëtare dhe të qytetarëve të shquar të shteteve të huaja si musafir të komunës.

### **Neni 29**

(1) Seanca e jashtëzakonshme thërritet për çështje me rëndësi për sigurinë e qytetarëve dhe në raste rrethanash të jashtëzakonshme.

(2) Seancën e jashtëzakonshme të Këshillit e thërret kryetari i Këshillit me iniciativën e tij, ose me kërkesën e më së paku një të tretës të anëtarëve të Këshillit ose me propozimin e kryetarit të komunës.

(3) Ftesa për seancën e jashtëzakonshme bashkë me propozimin e rendit të ditës u dorëzohet anëtarëve të Këshillit në një afat të mundshëm sa më të shkurt.

(4) Para fillimit të punës së seancës, anëtarët e Këshillit votojnë për arsyeshmërinë e shkaqeve për thërritjen e seancës së jashtëzakonshme pa debat dhe me shumicë të anëtarëve të pranishëm në Këshill.

### **Neni 30**

Në rast pengimi apo mosprezencës së kryetarit të Këshillit, seancat i kryeson anëtari më i vjetër i Këshillit.

## **1. Kryetari i komunës**

### **Neni 31**

(1) Kryetari i komunës e përfaqëson dhe e prezanton komunën.

(2) Kryetari i komunës zgjedhet në zgjedhje të përgjithshme, të drejtëpërdrejta dhe të lira me votim të fshehtë në pajtim me ligjin, për periudhë 4 vjeçare.

(3) Kryetari i komunës i kryen kompetencat e veta në suazat e përcaktuara me ligj dhe me këtë Statut.

### **Neni 32**

(1) Kryetari i komunës është i pranishëm dhe merr pjesë në punën e seancave të Këshillit, kurse sipas nevojës edhe në seancat e komisioneve të Këshillit dhe të trupave të posaçëme të komunës pa të drejtë vendosjeje.

(2) Kryetari i komunës mund të caktojë edhe përfaqësues të vet të cilët do të jenë të pranishëm dhe të marrin pjesë në punën e seancave të Këshillit, të komisioneve të tij dhe të trupave punuese të komunës.

(3) Kryetari i komunës ka për obligim të merr pjesë në seancat e Këshillit atëherë kur në rend të ditës është parashtrimi i pyetjeve të këshilltarëve, për të cilat jep përgjegje gojarisht ose me shkrim.

### **Neni 33**

Kryetari i komunës me iniciativën e vet dhe kërkesën e Këshillit e informon Këshillin për disa punë nga kompetencat e tij.

### **Neni 34**

Kryetari i komunës në suaza të kompetencave të veta:

- Inicon dhe propozon miratimin e akteve në kompetencë të Këshillit;
- Siguron kryerjen e punëve të përcjella nga organet e administratës shtetërore;
- Propozon buxhetin vjetor dhe llogarinë vjetore të buxhetit të komunës;
- E realizon buxhetin e komunës;
- Vendos për punë administrative për të drejtat, detyrimet dhe interesat e personave juridik dhe fizik, në pajtim me ligjin;
- Udhëheq me administratën komunale;
- Harton rregullore për sistematizimin e vendeve të punës të administratës komunale;
- Vendos për punësimin, të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e punëtorëve në administratën komunale nëse nuk është caktuar ndryshe me ligj;
- Kryetari i komunës i shpall aktet e Këshillit në "Fletoren zyrtare të komunës së Tearcës".
- Kryetari i komunës siguron zbatimin e Vendimeve të këshillit.
- Kryetari i komunës bashkëpunon me kryetarët e komunave tjera për çështje me interes të përbashkët dhe në kompetencat e komunave.
- Kryen edhe punë tjera të përcaktuara me ligj dhe me këtë Statut.

### **Neni 35**

(1) Kryetari i komunës është i detyruar në afat prej 7 (shtatë) ditësh prej ditës së dërgimit të aktit të Këshillit me Aktvendim ta ndalë shpalljen e tij nëse mendon se nuk është në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet.

(2) Një kopje të Aktvendimit të arsyetuar për mosshpallje i dërgohet kryetarit të Këshillit të komunës.

(3) Këshilli është i detyruar në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh prej ditës së shpalljes së Aktvendimit t'a shqyrtojë dhe të vendos për të.

(4) Nëse Këshilli e vërteton aktin ose nuk diskuton në afatin si në paragrafin 3 të këtij neni, Kryetari i komunës është i detyruar ta shpallë aktin dhe njëkohësisht të ngre nismë për ngritjen e procedurës për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë të dispozitës së kontestuar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë.

(5) Për nismën, Kryetari i komunës është i detyruar t'a informojë ministrinë kompetente për kryerjen e punëve që i përkasin vetëqeverisjes vendore.

### **Neni 36**

(1) Kryetari i komunës është i detyruar të paraqes Raport për zbatimin e Vendimeve të miratuara nga Këshilli çdo 3 (tre) muaj gjatë vitit.

(2) Për ushtrimin e kompetencave të veta, Kryetari i komunës e informon Këshillin sipas nevojës, së paku 2 (dy) herë gjatë vitit.

### **Neni 37**

(1) Kryetari i komunës udhëheq me pronën e komunës në interes publik dhe si nikoqir i mirë.

(2) Kryetari i komunës është i obliguar që në udhëheqjen me pronën e komunës, të ndërmer masa dhe ta siguroj shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e pronës së komunës në pajtueshmëri me ligjin.

### **Neni 38**

(1) Kryetari i komunës me vendim përcakton anëtar të Këshillit i cili do ta zëvendësojë gjatë kohës kur ai është i penguar që të jetë i pranishëm deri më gjashtë muaj.

(2) Vendimin nga paragrafi 1 i këtij neni Kryetari i komunës e nxjerr në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së funksionit.

(3) Vendimi i paragrafit 1 të këtij neni shpallet në "Gazetën zyrtare të komunës së Tearcës".

(4) Për paraqitjen e pengesës apo mosprezencës, Kryetari i komunës e informon kryetarin e Këshillit dhe anëtarin e Këshillit i cili do ta zëvendësojë.

(5) Anëtarit të Këshillit i pushon funksioni si këshilltarë gjatë kohës kur e zëvendëson Kryetarin e komunës.

## **2. Administrata komunale**

### **Neni 39**

(1) Për kryerjen e punëve në kompetencë të organeve të komunës organizohet administrata komunale.

(2) Administrata komunale organizohet në sektorë dhe sekcione (departamente).

(3) Komuna formon inspektorat komunal për ushtrimin e mbykqyrjes inspektuese ndaj kryerjes së punëve në kompetencë të saj.

### **Neni 40**

(1) Organizimi, fushëveprimi dhe mënyra e ushtrimit të detyrave të administratës komunale i përcakton Këshilli, me propozim të Kryetarit të komunës.

(2) Kryetari i komunës, me propozim të Agjencionit për nëpunësit shtetëror me Vendim do ta përcaktojë përkatësinë e titujve ekzistues në komunë me grupet dhe titujt e përcaktuar me Ligjin për nëpunësit shtetëror.

(3) Kryetari i komunës pas marrjes së Pëlqimit nga Agjencioni për nëpunës shtetëror sjell Rregullore për sistematizimin e vendeve të punës.

#### **Neni 41**

(1) Të punësuarit në administratën komunale që ushtrojnë punë profesionale, normativo-juridike, ekzekutive, administrativo-mbykqyrëse dhe vendosin çështje administrative, kanë status të nëpunësit shtetëror.

(2) Për punësimin, të drejtat dhe detyrimet, sistemin e rrogave dhe të kompenzimeve të rrogave, përgjegjësinë, vlerësimin dhe pushimin e marrëdhënies së punës së të punësuarve nga paragrafi 1 i këtij neni do të zbatohen dispozitat e Ligjit për nëpunësit shtetëror.

(3) Për të punësuarit në administratën komunale të cilët ushtrojnë punë administrativo-teknike dhe ndihmëse, zbatohen dispozitat e legjislacionit të punës.

(4) Gjatë punësimit në administratën komunale dhe në shërbimet publike që i ka themeluar komuna do të mbahet llogari për përfaqësim të drejtë dhe përkatës të qytetarëve që u takojnë të gjitha bashkësive të përfshira në komunë në të gjitha nivelet, si dhe respektimi i kriterëve të profesionalizimit dhe kopmetencës.

### **IV. AKTET E ORGANEVE TË KOMUNËS**

#### **a). Aktet e përgjithshme**

##### **Neni 42**

(1) Statuti është akt themelor i komunës me të cilin përcaktohen çështjet themelore lidhur me organizimin dhe punën e komunës dhe me çështje të tjera të rëndësishme për Komunën.

(2) Statuti i komunës miratohet në dy faza, si projekt-statut dhe si propozim-statut.

(3) Statutin e komunës e miraton Këshilli me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit të komunës.

##### **Neni 43**

(1) Këshilli i komunës miraton Rregulloren e punës së Këshillit, vendime, plane e programe, aktvendime, përfundime e akte tjera, jep mendime dhe përcakton kahje.

(2) Rregullorja e punës së Këshillit miratohet me shumicë votash të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit të komunës.

##### **Neni 44**

(1) Procedura e miratimit të akteve të përgjithshme rregullohet me Rregulloren e punës së Këshillit të komunës.

(2) Aktet e përgjithshme dhe aktet tjera shpallen në "Fletoren zyrtare të komunës së Tearcës".

(3) Aktet hyjnë në fuqi ditën e 8 (tetë) prej ditës së shpalljes.

#### **b). Aktet e veçanta**

##### **Neni 45**

(1) Këshilli dhe Kryetari i komunës sjellin akte të veçanta.

(2) Për zgjedhjen e të drejtave, obligimeve dhe interesave të veçanta të personave fizik dhe juridikë, Kryetari i komunës merr Aktvendim.

(3) Kryetari i komunës është i detyruar në afat prej 7 (shtatë) ditësh prej ditës së dërgimit të akteve t'i shpallë në "Fletoren zyrtare të komunës së Tearcës".

### **V.ORGANIZIMI DHE PUNA E KOMISIONEVE TË KËSHILLIT TË KOMUNËS**

#### **1. Komisionet e Këshillit**

##### **Neni 46**

(1) Për shqyrtimin e çështjeve në kompetencë të vet Këshilli formon Komisione.

(2) Komisionet e Këshillit formohen si të përhershme dhe të përkohshme.

(3) Me vendim për formimin e komisioneve, përcaktohet edhe fushëveprimi i punës së tyre.

(4) Mandati i komisionit zgjat aq sa zgjat edhe mandati i anëtarëve të Këshillit.

##### **Neni 47**

Këshilli i formon këto komisione të përhershme:

- Komisionin për çështje të verifikimit, zgjedhje dhe emërime;
- Komisionin për financa dhe zhvillim ekonomik vendor;
- Komisionin për planifikimin dhe rregullimin e hapësirës dhe mbrojtjen e ambientit jetësor e të natyrës;
- Komisionin për punë komunale dhe komunikacion;
- Komisionin për veprimtari shoqërore;
- Komisioni Statutar-Juridik;
- Komisioni për dhurata dhe mirënjohje;
- Komisioni për mundësi të njëjta;
- Këshilli mbykqyrës për kontrollë materialo- finansiare.

##### **Neni 48**

Komisioni për financa, buxhet dhe zhvillim ekonomik lokal i shqyrton çështjet lidhur me finansimin e komunës, miratimin e buxhetit dhe të llogarisë vjetore të buxhetit si dhe çështjet nga planifikimi dhe programimi i zhvillimit ekonomik lokal.

#### **Neni 49**

Komisioni për punë komunale dhe komunikacion i shqyrton çështjet nga lëmia e shërbimeve publike, të institucioneve publike dhe të ndërmarrjeve publike të komunës.

#### **Neni 50**

Komisioni për veprimtari shoqërore i shqyrton çështjet në kompetencë të komunës të cilat i përkasin kulturës, sportit dhe rekreimit, mbrojtjes sociale e mbrojtjes së fëmijëve, arsimin, mbrojtjes shëndetësore, sigurimit publik, sigurimit në komunikacion dhe mbrojtjes kundër zjarrit.

#### **Neni 51**

Komisioni Statutar-juridik përcakton propozimin e Statutit të komunës, shqyrton nismat dhe propozimet për ndryshimin e Statutit, përcjell zbatimin e tij dhe i shqyrton çështjet parimore me karakter statutar, përcakton propozimin e Rregullores së punës së Këshillit, përgatit propozim-mendime për propozim-ligjet që i përkasin komunës dhe shqyrton edhe akte të tjera të përgjithshme në kompetencë të Këshillit të komunës.

#### **Neni 52**

Komisioni për çështje mandatore, zgjedhje dhe emërime shqyrton dhe përgatit propozime të cilat u përkasin çështjeve të mandatit dhe imunitetit, shqyrton dhe përgatit propozime për zgjedhje, emërime dhe shkarkime në kompetencë të Këshillit të komunës, cakton rroga, kompenzime dhe të ardhura tjera të personave të zgjedhur dhe të emëruar, jep propozim për lartësinë e kompenzimit të harxhimeve për udhëtime dhe të mëditjeve të anëtarëve të Këshillit të komunës si dhe të harxhimeve të bëra në kryerjen e detyrave që ua ka besuar Këshilli i komunës.

Kryetarin dhe anëtarët e Komisionit i zgjedh Këshilli i komunës në seancën e tij të parë.

#### **Neni 53**

Komisioni për dhurata dhe mirënjohje shqyrton propozime dhe i propozon Këshillit ndarjen e dhuratave dhe të mirënjohjeve qytetarëve, organizatave dhe bashkësive që janë dalluar për zhvillimin e komunës në lëmi të caktuara ose si shprehje e mirënjohjes për zhvillimin e bashkëpunimit dhe të marrëdhënieve miqësore me subjekte të vendit dhe të huaja.

#### **Neni 54**

Komisioni për barabarësi gjinore i shqyrton çështjet që kanë të bëjnë me barabarësinë ndërmjet gjinive në të gjitha fushat e jetës shoqërore dhe jep mendim, propozime dhe sugjerime për zgjedhjen e problemeve dhe çështjeve që kanë të bëjnë me këtë problematikë.

### **2. Përbërja, zgjedhja dhe mënyra e punës së komisioneve**

#### **Neni 55**

Komisionet e Këshillit përbëhen nga kryetari dhe minimum dy anëtarë.

#### **Neni 56**

(1)Zgjedhja e kryetarit dhe anëtarit të komisionit të Këshillit bëhet me propozimin e komisionit për çështje të verifikimit, zgjedhje dhe emërime.

(2)Komisioni për çështje të verifikimit, zgjedhje dhe emërime e jep propozimin nga paragrafi 1 i këtij neni në bazë të propozimeve të paraqitura paraprakisht të partive politike të përfshira në Këshill, me ç'rast mban llogari për zbatimin e parimit të përfshirjes së tyre proporcionale në komisionet, duke pasur parasysh numrin e përgjithshëm të komisioneve të Këshillit.

(3)Zgjedhja e kryetarit dhe anëtarëve të komisionit bëhet me shumicën nga anëtarët e pranishëm të Këshillit.

#### **Neni 57**

Propozim për shkarkimin e kryetarit dhe të anëtarëve të komisionit mund të jep komisioni, komisioni për çështjet e verifikimit, zgjedhje dhe emërime, më së paku 3 (tre) anëtarë të Këshillit dhe kryetari i Këshillit.

Në bazë të propozimit për shkarkim vendos Këshilli, me vota publike, me shumicën e anëtarëve të pranishëm në Këshill.

#### **Neni 58**

Zgjedhje për shkak të ndërrimit të ndonjë anëtarit të komisionit bëhet me propozimin e Komisionit për çështjet e verifikimit, zgjedhje dhe emërime, me ç'rast nuk mundet të cënohet parimi i përfshirjes proporcionale të partive në komisionet.

#### **Neni 59**

Komisioni punon në seanca.

Rendi i ditës së seancave të komisionit përcaktohet në fillim të seancës.

#### **Neni 60**

Komisioni mund të punojë nëse në seancë janë të pranishëm shumica e anëtarëve të komisionit.

Komisioni vendos me shumicë votash nga anëtarët e pranishëm.

#### **Neni 61**

Nëse Komisioni vendos t'i paraqesë raport apo propozim Këshillit, përcakton raportuesin e vet, i cili me direktivat e Komisionit, me iniciativën e vet apo me kërkesën e Këshillit në seancën e Këshillit do ta argumentojë qëndrimin apo propozimin e komisionit.

#### **Neni 62**

Në seancën e komisionit në mënyrë të obligueshme merr pjesë edhe një përfaqësues i propozuesit të materialit që shqyrtohet.

Përfaqësuesi i propozuesit ka të drejtë që në seancën e komisionit të merr pjesë në shqyrtimin e propozimit që e ka dhënë.

### **Neni 63**

Komisioni ka të drejtë nga propozuesi të kërkojë sqarim si dhe të dhëna të tjera që i nevojiten për punë, e të cilat i posedon propozuesi apo është i obliguar t'i grumbullojë apo evidentojë.

### **Neni 64**

Në seancat e komisionit mund të jenë të pranishëm dhe të marrin pjesë në punën e tyre përfaqësues të organeve, organizatave, bashkësive dhe shoqatave, si dhe punonjës të tjerë shkencorë, profesional dhe publik, ashtu që t'i paraqesin mendimet e tyre lidhur me çështjet që shqyrtohen në seancën e komisionit.

Thirrje personave nga paragrafi 1 u dërgon kryetari në bazë të konsultimeve paraprake me anëtarët e komisionit.

## **3. Trupa të posaçme të komunës**

### **a) Komisioni për marrëdhënie midis bashkësive**

#### **Neni 65**

(1) Në komunë formohet Komisioni për marrëdhënie midis bashkësive (në tekstin e më tutjeshëm: Komision).

(2) Komisionin e përbëjnë nga (1) një përfaqësues i bashkësive të përfshirë në komunë, me mandat prej 4 (katër) vjetë.

(3) Anëtarët e komisionit nuk mund të zgjedhen nga radhët e anëtarëve të Këshillit.

#### **Neni 66**

(1) Vendim për formimin e Komisionit e merr Këshilli, me propozim të komisionit për çështjet e verifikimit, zgjedhjeve dhe emërimeve.

(2) Komisioni për çështjet e verifikimit, zgjedhjeve dhe emërimeve e formulon propozimin nga paragrafi 1 i këtij neni në bazë të propozimeve të marra paraprakisht nga partitë politike të përfshira në Këshill.

#### **Neni 67**

Komisioni nga radhët e anëtarëve të vet zgjedh kryetarin me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit, me votim të fshehtë.

#### **Neni 68**

(1) Komisioni punon në seanca.

(2) Seancat i thërret dhe ato i udhëheq kryetari i komisionit.

(3) Komisioni mund të punojë nëse në seancë janë të pranishëm shumica nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të komisionit.

(4) Komisioni vendos me shumicë nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të komisionit.

(5) Në seancat e Komisionit mund të jenë të pranishëm dhe të marrin pjesë në debat: kryetari i komunës dhe kryetari i Këshillit, pa të drejtë vendosjeje.

## **b) Këshilli për mbrojtjen e konsumatorëve**

### **Neni 69**

(1) Në komunë formohet Këshilli për mbrojtjen e konsumatorëve.

(2) Këshilli për mbrojtjen e konsumatorëve është i përbërë nga 10 anëtarë, përfaqësues të grupeve më të mëdha të konsumatorëve të shërbimeve publike të komunave.

(3) Anëtarët e Këshillit për mbrojtjen e konsumatorëve nuk mund të zgjedhen nga radhët e anëtarëve të Këshillit të komunës.

### **Neni 70**

(1) Vendim për formimin e Këshillit për mbrojtjen e konsumatorëve merr Këshilli i komunës me propozimin e Komisionit për çështjet e verifikimit, zgjedhje dhe emërime.

(2) Komisioni për çështjet e verifikimit, zgjedhje dhe emërime e formulon propozimin nga paragrafi 1 i këtij neni sipas propozimeve të marra paraprakisht nga format e vetëvendosjes vendore në Komunë.

### **Neni 71**

Këshilli për mbrojtjen e konsumatorëve nga radhët e anëtarëve të vet zgjedh kryetarin, me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit për mbrojtjen e konsumatorëve, me votim të fshehtë.

### **Neni 72**

Këshilli për mbrojtjen e konsumatorëve punon në seanca.

Seancat sipas rregullës janë publike (të hapura).

Seancat i thërret dhe me to udhëheq kryetari i Këshillit për mbrojtjen e konsumatorëve.

Këshilli për mbrojtjen e konsumatorëve mundet të punojë nëse në seancë janë të pranishëm shumica nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit për mbrojtjen e konsumatorëve.

Këshilli për mbrojtjen e konsumatorëve vendosë me shumicë nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit për mbrojtjen e konsumatorëve.

Në seancat e Këshillit për mbrojtjen e konsumatorëve mund të jenë të pranishëm dhe në punën e tyre mund të marrin pjesë, Kryetari i komunës dhe kryetari i Këshillit të komunës, pa të drejtë vendosjeje.

### **Neni 73**

Këshilli për mbrojtjen e konsumatorëve shqyrton çështje dhe përcakton propozime që kanë të bëjnë me cilësinë e shërbimeve që ofrojnë shërbime publike të komunës, kurse posaçërisht:

- përcjell gjendjen e dhënies së shërbimeve nga ana e shërbimeve publike;
- kujdeset për zgjidhjen e problemeve që i kanë qytetarët gjatë shfrytëzimit të shërbimeve nga ndërmarrjet dhe institutet që kryejnë shërbime publike;
- kujdeset për përparimin e sjelljes së të punësuarve të dhënësit e shërbimeve ndaj shfrytëzuesve të shërbimeve;
- organizon tribuna publike dhe forma tjera të pjesëmarrjes së qytetarëve në të cilat do të debatohet për përparimin dhe mbrojtjen e shpenzuesve.

### **c) Trupi participues nga sfera e urbanizmit**

#### **Neni 74**

(1) Në komunë formohet trup participues nga sfera e urbanizmit (këshill) për të përcjellur qëndrimet dhe mendimet e qytetarëve dhe subjekteve juridikë në procesin e planifikimit urbanistik, si dhe për të përcjellë gjendjet dhe dhënien e iniciativave, orientimeve dhe sugjerimeve në procesin e planifikimit dhe përgatitjes së vendimeve planore për komunën.

(2) Trupi participues nga sfera e urbanizmit përbëhet nga pesë anëtarë.

#### **Neni 75**

(1) Vendim për formimin e trupit participues nga sfera e urbanizmit merr Këshilli, me propozim të komisionit për çështje të verifikimit, zgjedhjeve dhe emërimeve.

(2) Anëtarët e trupit participues nga sfera e urbanizmit zgjedhen:

- nga radhët e anëtarëve të Këshillit;
- me propozimin e formave të vetëvendosjes vendore;
- me propozimin e shoqatave të qytetarëve;
- shoqatave të personave profesionalë nga sfera e urbanizmit, dhe nga administrata komunale.

#### **Neni 76**

Trupi participues nga sfera e urbanizmit nga radhët e anëtarëve të vet, zgjedh kryetarin, me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të trupit participues, me votim publik.

#### **Neni 77**

Trupi participues nga sfera e urbanizmit punon në seanca.

Seancat janë publike.

Seancat i thërret dhe i udhëheq kryetari i Trupit participues nga sfera e urbanizmit.

Trupi participues nga sfera e urbanizmit mund të punojë nëse në seancë merr pjesë shumica nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

Trupi participues nga sfera e urbanizmit vendos me shumicë nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

Në seanca mund të jenë të pranishëm dhe të marrin pjesë në punën e tyre, kryetari i komunës dhe kryetari i Këshillit, pa të drejtë vendosjeje.

## **VI. KRYERJA E PUNËVE SIPAS PARIMIT TË SUBSIDIARITETIT**

### **Neni 78**

Komuna në suazat e ligjit, në pajtueshmëri me parimin e subsidiaritetit, ka të drejtë që në rajonin e vet të zbatojë iniciativa lidhur me të gjitha çështjet me rëndësi për Komunën, që nuk janë të përjashtuara nga kompetencat e saj ose që nuk janë në kompetencat e organeve të pushtetit shtetëror.

Përcaktimi i punëve nga paragrafi 1 i këtij neni, definimi i përmbajtjes së tyre, mënyra dhe procedura e kryerjes së tyre, rregullohen me vendime të posaçme të Këshillit, me propozimin e kryetarit të komunës.

### **Neni 79**

Komuna mund të ndajë shpërblime.

(1) Shpërblimet ndahen në shenjë mirënjohjeje për rezultatet e arritura që paraqesin kontribut të posaçëm për zhvillimin e Komunës dhe të përparimit të saj të gjithmbarshëm si dhe për afirmimin në sferën e zhvillimit ekonomik, shkencor, artistik, kulturor, arsimor, atë të mbrojtjes shëndetësore, të mbrojtjes sociale, sportit, mbrojtjes dhe përparimit të ambientit jetësor dhe të natyrës si dhe në sfera të tjera.

(2) Shpërblimi mund t'u ndahet subjekteve fizike dhe juridike nga Komuna, Republika dhe shtete të tjera, si dhe organizatave ndërkombëtare dhe asociacioneve apo përfaqësuesve të tyre.

### **Neni 80**

(1) Këshilli formon këshill për ndarjen e shpërblimit.

(2) Puna e këshillit rregullohet për së afërmi me vendimin e Këshillit të komunës.

(3) Mjetet për shpërblim dhe për punën e këshillit sigurohen nga buxheti i komunës dhe nga burime tjera hyrëse.

### **Neni 81**

Komuna mund të konstatojë edhe shpërblime dhe mirënjohje të tjera.

## **VII. INFORMIMI I QYTETARËVE DHE QASJA E LIRË NË INFORMATAT ME KARAKTER PUBLIK**

### **a) Informimi i qytetarëve**

#### **Neni 82**

Organet e Komunës, komisionet e Këshillit të komunës dhe ndërmarrjet dhe institutet publike të themeluara nga Komuna i informojnë qytetarët me vendimet dhe aktivitetet e veta që janë me rëndësi të drejtpërdrejtë për jetën dhe punën e qytetarëve në Komunë dhe me informata tjera me interes publik.

#### **Qytetarët informohen për:**

- rregullat që i nxjerr Këshilli i komunës;
- mënyrën dhe kushtet për realizimin e të drejtave të tyre;
- obligimet e qytetarëve që dalin nga kompetencat e Komunës;
- planet, projektet dhe programet që janë në përgatitje e sipër kurse janë me rëndësi për zhvillimin e Komunës;
- shërbimet që i marrin nga shërbimet publike dhe administrata e qytetit dhe me mënyrën e marrjes së tyre;
- të ardhurat që realizohen në Komunë dhe mënyrën e shpërndarjes dhe shpenzimit të tyre;
- furnizimet publike;
- emërimin e drejtorëve dhe përfaqësuesve në këshillat drejtuese të ndërmarrjeve dhe instituteve publike;
- si dhe informata të tjera që dalin nga kompetencat e organeve të Komunës dhe të ndërmarrjeve e instituteve publike në pajtueshmëri me ligjin.

#### **Neni 83**

Informimi i qytetarëve bëhet në mënyrë të rregullt, pa kompenzim përmes:

- botimit të fletores zyrtare të komunës;
- botimit dhe distribuimit deri te qytetarët të buletineve mujore informative;
- botimit të publikimeve;
- të zyrave informative të udhëhequra nga administrata komunale dhe shërbimet publike të themeluara nga Komuna;
- të tabelave të shpalljes (në hapësirat e komunës të ndërmarrjeve dhe instituteve publike dhe të vetvendosjes vendore);
- veb sajteve (web sites);
- tribunave publike;
- mjeteve të informimit dhe
- mënyrave tjera adekuate më të volitshme për informimin e opinionit.

#### **Neni 84**

(1) Informimi i qytetarëve bëhet në gjuhët zyrtare që përdoren në Komunë.

(2) Këshilli i Komunës me vendim të posaçëm mund të caktojë që për disa informata, informimi të bëhet edhe në gjuhën që nuk është gjuhë zyrtare në Komunë e që atë e flasin një pjesë e banorëve të Komunës.

#### **b) Qasja e lirë në informatat me karakter publik**

## **Neni 85**

(1) Në Komunë sigurohet e drejta e qasjes së lirë në informatat me karakter publik me të cilat posedojnë organet e Komunës (Këshilli dhe kryetari i Komunës), ndërmarrjet dhe institutet publike të themeluara nga Komuna si dhe subjekte juridike dhe fizike që kanë kompetenca publike të besuara nga komuna (në tekstin e mëtutjeshëm poseduesit e informatave).

(2) Me përjashtim në raste të përcaktuara me ligj, e drejta e qasjes së lirë në disa informata të cilat i posedojnë poseduesit e informatave nga paragrafi 1 i këtij neni, mund të jetë e kufizuar ose të sigurojë qasje të pjesërishtme.

## **Neni 86**

(1) Për informatat të cilat i posedon dhe ndaj të cilave sigurohet qasje e lirë, poseduesit e informatave formojnë dhe udhëheqin listën e informatave e cila shpallet në mënyrë të kapshme për kërkuesit e informatave.

(2) Për listën e informatave dhe për kushtet dhe mënyrën e qasjes së lirë në informatat, qytetarët informohen përmes tabelës së shpalljes ose në mënyrë tjetër të volitshme.

(3) Poseduesit e informatave janë të obliguar rregullisht çdo tre muaj ta azhurojnë listën e informatave me karakter publik të cilat i posedojnë.

(4) Listën e informatave me karakter publik për organet e Komunës, e propozon Kryetari i Komunës kurse e përcakton Këshilli.

(5) Listën e informatave me karakter publik për ndërmarrjet dhe institutet publike të themeluara nga Komuna e përcakton Këshilli drejtues me propozimin e drejtorit.

## **Neni 87**

(1) Procedura për realizimin e të drejtës së qasjes së lirë në informatat realizohet në pajtueshmëri me ligjin.

(2) Kryetari i Komunës krijon kushte dhe ndërmerr masat e parapara me ligj, për realizimin e të drejtës së qasjes së lirë në informatat me karakter publik të cilat i posedojnë Këshilli dhe administrata e Komunës.

(3) Drejtori i ndërmarrjes dhe institutit publik të themeluar nga Komuna, krijon kushte dhe ndërmerr masa që i parasheh ligji, për realizimin e të drejtës së qasjes së lirë në informatat me karakter publik të cilat i posedon në pajtueshmëri me statutin e ndërmarrjes dhe institutit.

## **Neni 88**

(1) Qasje të lirë në informatat me karakter publik me të cilat disponon poseduesi i informatave, kanë të gjithë subjektet juridike dhe fizike (në tekstin e mëtutjeshëm: kërkuesi i informatave).

(2) Qasja e lirë në informatat realizohet në afatin e caktuar ligjor:

- me shikimin e dokumenteve të cilat i posedon poseduesi i informatave;
- me marrjen e duplikatit, fotokopjes apo shënimit elektronik nga dokumentet të cilat i posedon poseduesi i informatave.

(3) Poseduesi i informatave për ndërmjetësim gjatë realizimit të së drejtës së qasjes së lirë në informatat, cakton një person zyrtar.

#### **Neni 89**

(1) Kërkuesi i informatave për shikimin e kryer apo duplikatin e marrë, fotokopjen nga shënimi elektronik i informatës, paguan një kompensim adekuat në lartësi të shpenzimeve materiale, të përcaktuara në mënyrën e rregulluar me ligj.

(2) Kërkuesi i informatës gjatë paraqitjes së kërkesës, informohet për pagimin e lartësisë së kompensimit gjegjësisë.

(3) Kërkuesi i informatës ka të drejtë ankese në organin kompetent për mbrojtjen e të drejtës së qasjes së lirë në informatat e karakterit publik nëse poseduesi i informatës nuk ia jep informatën e kërkuar.

#### **Neni 90**

(1) Këshilli i Komunës miraton raportin vjetor për realizimin e të drejtës së qasjes së lirë në informatat për vitin e kaluar në Komunë.

(2) Raportin vjetor për realizimin e qasjes së lirë në informatat e përgatit Kryetari i Komunës, i cili ia dërgon Këshillit, më së voni deri më 31 janar në vitin rjedhës.

(3) Raporti nga paragrafi 1 i këtij neni i përmban të dhënat për qasjen e lirë të realizuar në informatat me të cilat posedojnë edhe shërbimet publike të cilat i formon Komuna.

(4) Raporti nga paragrafi 1 pas miratimit i dërgohet organit kompetent për mbrojtjen e të drejtës së qasjes së lirë në informatat me karakter publik.

### **VIII. PËRJASHTIMI I OPINIONIT NGA SEANCAT E KËSHILLIT**

#### **Neni 91**

(1) Këshilli mund të punojë pa praninë e opinionit vetëm në raste të caktuara me ligj dhe me këtë statut si dhe kur atë do ta propozojnë Kryetari i Komunës, kryetari i Këshillit ose më së paku 3 (tre) anëtarë të Këshillit.

(2) Përjashtimi i opinionit mund të kërkohet, kur çështja për të cilën diskutohet, ka pika prekëse me moralin publik; kur mund t'i rrezikojë interesat e një personi të caktuar apo të ketë pika prekëse me mbrojtjen dhe sigurinë e qytetarëve.

(3) Sipas propozimit nga paragrafi 1 i këtij neni, Këshilli vendos pa debat, me shumicën e dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit.

### **IX. PARASHTRESA DHE PROPOZIME**

#### **Neni 92**

Subjektet fizike dhe juridike kanë të drejtë të paraqesin parashtresa dhe propozime që kanë të bëjnë me punën e organeve dhe administratën e komunës.

### **Neni 93**

(1)Parashtresat dhe propozimet paraqiten në formë të shkruar apo gojorisht në procesverbal para personit të autorizuar administrativ.

(2)Për parashtresat dhe propozimet nuk paguhet tatim.

### **Neni 94**

Paraqitësi nuk guxon të përjetojë pasoja të dëmshme për shkak të paraqitjes së parashtresës apo propozimit e as që mund të thërritet në përgjegjësi për atë gjë.

### **Neni 95**

(1)Kryetari i komunës, varësisht nga përmbajtja e parashtresës gjegjësisht e propozimeve, autorizon një apo disa nëpunës të veprojnë lidhur me parashtresën gjegjësisht propozimin.

(2)Veprimi lidhur me parashtresën gjegjësisht propozimin, përfshin grumbullimin e të dhënave, informatave dhe mendimeve për rrethanat që janë me rëndësi për vlerësimin e drejtë të bazës së parashtresës ose për arsyeshmërinë e propozimit, si dhe ndërmarrjen e masave të nevojshme për evitimin e cënimit eventual të së drejtës së paraqitësit apo të cënimit të interesit publik.

### **Neni 96**

Kryetari i komunës është i obliguar që në afat sa më të shkurtë që mundet, kurse më së voni në afat prej 60 ditësh nga dita e marrjes së parashtresës gjegjësisht propozimit, paraqitësit t'i jep përgjigje.

## **X. TRIBUNA PUBLIKE, ANKETA DHE PROPOZIME TË QYTETARËVE**

### **Neni 97**

(1)Organet e komunës për shkak të përcaktimit të politikës në një sferë të caktuar, marrjes së masave për zgjidhjen e çështjeve dhe problemeve me rëndësi për qytetarët nga rajoni i Komunës, si dhe gjatë propozimit të akteve të caktuara nga kompetencat e veta mund të organizojnë tribuna publike, të bëjnë anketa apo të grumbullojnë propozime nga qytetarët.

(2)Lloji, procedura, mënyra dhe koha e organizimit të formave të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve nga paragrafi 1 i këtij neni, rregullohet me akt të organit që e organizon.

(3)Për organizimin e tribunave publike, zbatimin e anketave dhe marrjen e propozimeve të qytetarëve, shpallet kumtesë në mjetet e informimit publik, në të cilën shënohet lloji, qëllimi, lënda dhe të dhënat tjera të rëndësishme për organizimin e formës adekuate të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve dhe thërriten të interesuarit të marrin pjesë në to.

(4)Organizimi i tribunave publike, realizimi i anketave dhe marrja e propozimeve nga qytetarët, mund të bëhet në bashkëpunim me komunat tjera dhe me format e vetëvendosjes vendore.

(5)Për tribuna publike, anketat apo propozimet e qytetarëve përgatitet raport.

### **Neni 98**

Gjatë organizimit të tribunave, zbatimit të anketave apo grumbullimit të propozimeve nga qytetarët sigurohet:

- teksti i dokumentit apo projekti i vendimit dhe akt tjetër i përgjithshëm i shpallur në mënyrë adekuate që të kenë qasje qytetarët dhe subjektet tjerë të interesuar;
- marrjen dhe shqyrtimin e mendimeve dhe propozimeve të dhëna dhe
- përgatitjen e raportit.

#### **Neni 99**

Mënyra dhe procedura e organizimit të tribunës publike, zbatimit të anketës dhe grumbullimit të propozimeve të qytetarëve, rregullohen me Rregulloren.

### **XI. KRYERJA E OBLIGIMEVE NGA SFERA E MBROJTJES NË GJENDJE LUFTE**

#### **Neni 100**

**Në gjendje lufte, organet e Komunës:**

- (1) vazhdojnë t'i kryejnë punët e përcaktuara me ligj, dhe
- (2) ndërmarrin masa për mbrojtjen dhe shpëtimin e qytetarëve dhe të begative materiale në rajonin e vet nga shkatërrimet luftarake, fatkeqësitë elementare natyrore dhe fatkeqësitë tjera si dhe nga pasojat e shkaktuara prej tyre.

**Komuna përgatitet për kryerjen e obligimeve nga paragrafi 1 i këtij neni përmes:**

- (1) planifikimit dhe eorganizimit të masave për mbrojtjen dhe shpëtimin për nevojat e veta;
- (2) formimit të njërive të shtabeve të mbrojtjes civile, në pajtueshmëri me ligjin dhe rregullat të themeluara me ligj;
- (3) stërvitjes për mbrojtje, gjegjësisht kyçjes në aktivitetet për fitimin e njohurive të domosdoshme luftarako-profesionale dhe të njohurive tjera për pjesëmarrje në mbrojtje;
- (4) ndërmarrjes së masave, aktiviteteve dhe veprimeve tjera për mbrojtjen dhe ruajtjen e fshehtësisë të të dhënave, informatave dhe dokumenteve nga sfera e mbrojtjes, në pajtueshmëri me ligjin dhe rregullat e themeluara me ligj;
- (5) koordinimit dhe bashkëpunimit me komunat tjera.

### **XII. MËNYRA E SHPALLJES SË RREGULLAVE TË KËSHILLIT**

#### **Neni 101**

(1) Rregullat e Këshillit shpallen në "Fletoren zyrtare të Komunës" para se të hynë në fuqi.

(2) Buletini zyrtarë i komunës është "Fletorja zyrtare e komunës Tearcës".

(3) Në mjetin informativ zyrtar të komunës mund të shpallen edhe rregulla të komunave tjera.

#### **Neni 102**

Rregullat e komunës hynë në fuqi ditën e tetë nga e dita e shpalljes në "Fletoren zyrtare të Komunës" kurse me përjashtim të cilin e përcakton Këshilli, më parë se ditën e shpalljes.

## **Rregullat e Këshillit mund të hynë në fuqi edhe në afat më të shkurtër se tetë ditë nëse:**

- (1) shkaqet për të cilat propozohet nxjerrja e rregullave dhe qëllimet që dëshirohet të arrihen me nxjerrjen e tyre janë të karakterit urgjent dhe të pashtyeshëm;
- (2) nuk krijojnë obligime materiale për qytetarët dhe subjekteve juridike;
- (3) çështjet që rregullohen janë nga sfera e mbrojtjes dhe shpëtimit e të ngjashme;
- (4) atë i imponojnë parimet e racionalitetit, efikasitetit, ekonomizimit, operativitetit e të ngjashme.

## **XIII. VETËVENDOSJA VENDORE**

### **Neni 103**

Qytetarët e komunës vendosin për punët me rëndësi të drejtpërdrejtë dhe të përditshme të jetës dhe punës së tyre edhe përmes formave të vetëvendosjes vendore të cilat mund t'i themelojnë në pajtueshmëri me këtë Statut.

### **Neni 104**

Në komunë si forma të vetëvendosjes vendore mund të themelohen bashkësi lokale.

### **Neni 105**

Rajoni për të cilin themelohen bashkësitë lokale janë kufijtë e komunave të katastroit të vendeve të banuara.

### **Neni 106**

(1) Iniciativë për themelimin e bashkësisë lokale mund të ngrejnë më së paku 10 % të qytetarëve, banorë të rajonit në të cilin ka interes për themelimin e bashkësisë lokale.

(2) Iniciativa mund të paraqitet nëse plotësohen kushtet e parapara në këtë Statut.

### **Neni 107**

Iniciativa për themelim përmban: araqitësin, përshkrimin e rajonit për të cilin kërkohet themelimi i bashkësisë lokale, sqarimi i nevojave për themelim dhe nënshkrimin e qytetarëve të interesuar.

### **Neni 108**

(1) Vendimi për themelimin e bashkësisë lokale merret në tubimin e qytetarëve në rajonin përkatës përmes votimit publik me shumicën e votave nga qytetarët e pranishëm.

(2) Tubimin e qytetarëve nga paragrafi i mëparshëm i këtij neni, e thërret kryetari i Komunës, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së vendimit.

### **Neni 109**

Qytetarët përmes bashkësisë lokale, në pajtueshmëri me këtë Statut dhe vendimet për themelim kujdesen për:

- (1) zgjidhjen e çështjeve nga infrastruktura komunale për rajonin gjegjës;
- (2) mirëmbajtjen e objekteve me interes publik (ujësjellës, rrugë, pallate të kulturës, objekte sportive etj.);
- (3) mbrojtjen e ambientit jetësor dhe natyrës;
- (4) rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave në vendbanimet fshatare;
- (5) ngritjen e iniciativës për rregullimin e hapësirës;
- (6) organizimin e manifestimeve kulturore, sportive, argëtuese e të tjera dhe
- (7) punë të tjera me rëndësi të drejtpërdrejtë përditshme për jetën dhe punën e qytetarëve.

#### **Neni 110**

Këshilli i bashkësisë lokale jep iniciativa dhe propozime në organet kompetente të komunës për çështje nga sfera e arsimit, shendetësisë, mbrojtjes sociale dhe çështje të tjera me interes për qytetarët.

#### **Neni 111**

Punët nga neni 109 këtij Statuti financohen nga:

- (1) mjetet që komuna do t'ua ndajë bashkësive lokale në pajtueshmëri me planet dhe programet për zhvillimin e tyre;
- (2) mjetet që qytetarët i bashkojnë drejtpërdrejt;
- (3) mjetet që do ti ndajnë subjektet e interesuara juridike dhe fizike;
- (4) mjetet nga kompenzimi i shërbimeve dhe
- (5) dhuratat dhe mjetet tjera.

Mbledhja dhe shpenzimi i mjeteve nga paragrafi 1 kryhet përmes buxhetit të Komunës.

#### **Neni 112**

(1)Organ i formave të vetëvendosjes vendore është Këshilli.

(2)Këshillin e bashkësisë lokale e zgjedhin qytetarët në tubimin e qytetarëve me vota publike, nëse tubimi nuk vendos që votimi të jetë i fshehtë.

(3)Këshilli i bashkësisë lokale përbëhet nga 5 (pesë) deri 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë.

(4)Mandati i anëtarëve të Këshillit të vetëvendosjes vendore zgjatë 4 (katër) vjet.

#### **Neni 113**

(1)Vendim për shpalljen e zgjedhjeve të anëtarëve të Këshillit të bashkësisë lokale paraqet Këshilli në përbërjen e vjetër, më së voni 30 ditë para skadimit të afatit.

(2)Nëse vendimi nga paragrafi 1 i këtij neni nuk merret në afatin e përcaktuar, vendim për shpalljen e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit të bashkësisë lokale, merr Tubimi i qytetarëve.

#### **Neni 114**

(1) Propozimi dhe përcaktimi i kandidatëve për anëtarë të Këshillit të bashkësisë lokale, bëhet në Tubimin e qytetarëve, nëse në të marrin pjesë më së paku 10% të qytetarëve banorë të bashkësisë gjegjëse vendore.

(2) Të përcaktuar konsiderohen kandidatët të cilët kanë fituar shumicë gjegjësisht numrin më të madh të votave nga qytetarët e pranishëm në tubim.

#### **Neni 115**

Procedura për propozimin, përcaktimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të bashkësisë lokale rregullohet për së afërmi me rregullat për punën e bashkësive lokale të miratuara nga Këshilli i komunës.

#### **Neni 116**

Për anëtarë të zgjedhur të Këshillit të bashkësisë lokale konsiderohen kandidatët që kanë fituar shumicë gjegjësisht numër më të madh votash nga zgjedhësit që kanë votuar.

#### **Neni 117**

Këshilli i bashkësisë lokale zgjedh nga radhët e anëtarëve të vet, kryetarin i cili e përfaqëson dhe prezenton bashkësinë lokale.

#### **Neni 118**

(1) Kryetari i Komunës me vendim mund të delegojë kryerjen e një pune të caktuar me interes të drejtpërdrejtë dhe me rëndësi ordinare për jetën dhe punën e banorëve me pajtueshmërinë paraprake të kryetarit të Këshillit të bashkësisë lokale.

(2) Mjetet e nevojshme për kryerjen e punëve nga paragrafi 1 i këtij neni përcaktohen me vendimin për delegimin e kompetencave.

(3) Me këtë vendim përcaktohet organi dhe mënyra e kryerjes së mbikqyrjes mbi kryerjen e punëve nga paragrafi 1 i këtij neni.

#### **Neni 119**

Administrata komunale i kryen punët profesionale, administrative-teknike dhe punët e kontabilitetit dhe të financave të bashkësive lokale.

Kontrollin mbi shpenzimin e mjeteve që do të akordohen për kryerjen e kompetencave të deleguara e bën administrata komunale.

#### **Neni 120**

Komuna mban evidencën e bashkësive lokale të themeluara në rajonin e saj.

### **XIV. PRONËSIA DHE FINANCIMI I KOMUNËS**

#### **a) Pronësia**

#### **Neni 121**

(1) Pronën e komunës e përbëjnë sende të luajshme dhe të paluajshme, mjete në para dhe të drejta.

(2) Komuna e fiton pronën nga burimet e veta të të hyrave me financim të qytetarëve ose me pjesëmarrjen e tyre në formë tjetër, me dhurata dhe në baza të tjera.

#### **Neni 122**

(1) Për blerjen, tjetërsimin dhe ngarkesën e pronës së komunës vendos Këshilli i komunës.

(2) Tjetërsimi i pronës së komunës bëhet vetëm me anëkdand publik në pajtim me ligjin.

(3) Çmimi shitës i gjërave nuk guxon të jetë më i vogël se vlera e tyre e tregut.

(4) Komuna evidenton pronën e vet dhe vlerësimi i saj paraqitet në llogarinë vjetore.

#### **b) Financimi**

#### **Neni 123**

(1) Komuna financohet nga burimet vetanake të të hyrave, tatimet, kompenzimet dhe taksat lokale të përcaktuara me ligj, dotacione të mjeteve nga Buxheti i R.M. dhe nga buxhetet e fondeve si dhe nga burime të tjera të përcaktuara me Ligjin për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale.

(2) Financimi dhe puna financiare e komunës në tërësi, rregullohet me ligje të veçanta.

### **XV. PËRDORIMI I GJUHËVE DHE SHKRIMEVE NË KOMUNËN E TEARCËS**

#### **Neni 124**

Në territorin e komunës së Tearcës gjuhë zyrtare janë gjuha maqedonase dhe shkrimi i saj qirilik dhe gjuha shqipe dhe shkrimi i saj.

#### **Neni 125**

(1) Emrat e vendbanimeve në komunë, titujt e shërbimeve dhe institucioneve publike, mbyshkrimet e institucioneve kulturore dhe arsimore, mbishkrimet e ndërmarrjeve dhe mbishkrimet e tjera publike dhe aktet e tyre të përgjithshme, si dhe korespondenca për komunikim me qytetarët dhe subjektet tjera shkruhen në gjuhën maqedonase dhe shqipe.

(2) Mbishkrimet e institucioneve kulturore dhe arsimore të cilat shërbejnë vetëm për zhvillimin dhe përparimin e qëllimeve kulturore dhe arsimore të nacionaliteteve, përpos në gjuhën maqedonase dhe shqipe, shkrimet e tyre shkruhen edhe në gjuhën dhe shkrimin e nacionalitetit përkatës.

### **XVI. MËNYRA DHE PROCEDURA E PËRCAKTIMIT DHE E PËRDORIMIT TË STEMËS DHE FLAMURIT TË KOMUNËS**

#### **Neni 126**

(1) Stema dhe flamuri i komunës përcaktohet me Vendim të Këshillit të komunës.

(2)Për përcaktimin e stemës dhe të flamurit të komunës, Këshilli i komunës shpall konkurs dhe formon komision.

#### **Neni 127**

(1)Stema e komunës përdoret në përbërje të vulës së komunës.

(2)Stema e komunës mund të përdoret edhe në thirrje zyrtare, fletë urime dhe në akte të ngjashme që i shfrytëzon Këshilli dhe Kryetari i komunës.

#### **Neni 128**

(1)Flamuri i komunës vendoset në ndërtesën e komunës dhe në vende të dukshme në komunë.

(2)Flamuri i komunës mund të nxjerret edhe gjatë takimeve ndërkombëtare, garave dhe tubimeve të tjera në të cilat merr pjesë ose prezentohet komuna.

### **XVII.MBROJTJA E KOMUNËS**

#### **Neni 129**

(1) Nismë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve dhe të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së akteve të përgjithshme dhe të drejtat e komunës të përcaktuara me Kushtetutë dhe ligj mund ta paraqes Këshilli, përkatësisht kryetari i komunës në Gjykatën Kushtetuese të R.M.

(2) Kryetari i komunës ka të drejtë të kërkojë mbrojtje gjyqësore në gjykatat kompetente kur komunës i pengohet ushtrimi i kompetencave të dhëna me Kushtetutë dhe ligj.

### **XVIII. NDRYSHIMI DHE PLOTËSIMI I STATUTIT**

#### **Neni 130**

Ndryshime dhe plotësime të Statutit të Komunës mund të propozojnë së paku ½ e anëtarëve të Këshillit, kryetari i komunës ose më së paku 10% e zgjedhësve në komunë.

#### **Neni 131**

Vendim për fillimin e ndryshimeve të Statutit merr Këshilli i komunës me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të këshillit.

#### **Neni 132**

Ndryshimet e Statutit të komunës janë miratuar nëse për ta ka votuar shumica nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit të komunës.

### **XIX.DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

#### **Neni 133**

Poseduesit e informatave nga neni 82 i këtij Statuti janë të obliguar në afat prej gjashtë muaj nga dita e nxjerrjes së këtij Statuti, të nxjerrin dhe shpallin listën e informatave nga neni 84 i këtij Statuti.

#### **Neni 134**

Kryetari i komunës në afat prej tre muaj nga dita e nxjerrjes së këtij Statuti, në pajtueshmëri me aktin për organizimin e administratës komunale, do të caktojë një nëpunës shtetëror nga administrata, i cili do t'i kryejë punët e ndërmjetësimit gjatë realizimit të së drejtës të qasjes së lirë në informatat me karakter publik.

#### **Neni 135**

Në afat prej 3 muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Statuti, komuna do t'i përfshijë në evidencë format ekzistuese të vetëvendosjes vendore të themeluara në pajtueshmëri me Statutin e komunës.

#### **Neni 136**

Me hyrjen në fuqi të këtij Statuti, pushon të vlejë Statuti i komunës së Tearcës nr.07-11/1, ("Fletorja zyrtare e Komunës", nr.1/2003).

#### **Neni 137**

Ky Statut hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Fletoren zyrtare të komunës së Tearcës".

**Nr.07-486/1**

**28.05.2007**

**Tearcë**

**Këshilli i komunës së Tearcës**